



**Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit**  
**Permanent Tribunal of Arbitration**

Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit  
Oda Ekonomike e Kosovës  
*Permanent Tribunal of Arbitration*  
*Kosova Chamber of Commerce*

Zyra Nr.22, Nëna Terezë, Nr.20,  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381 (0) 38 780 313  
Fax: +381(0) 38 224 299  
info@kosovo-arbitration.com  
www.kosovo-arbitration.com

**PËRMBLEDHJA E RASTIT TË ARBITRAZHIT**

**TABELA E PËRMBAJTJES**

|     |   |   |
|-----|---|---|
| 1.  | Përmbledhja e fakteve.....                                    | 1 |
| 2.  | Vlerësimi ligjor .....  | 2 |
| (a) | Jurisdikcioni I Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit ..... | 2 |
| (b) | Forma e kontratës.....  | 3 |
| 3.  | Vendimi.....  | 3 |

**1. PËRMBLEDHJA E FAKTEVE**

Me datën 19 maj 2006, paditësi “Kompania A” nënshkroi kontratën me “kompaninë B”, me ç’rast morri përsipër të kryej punët e ndërtimit siç ishin të specifikuara në dokumentacionin e tenderit, proces tenderimi ky I vitit 2005.

Kontrata ishte e bazuar në modelin e vitit 1992 të *Federatin Internationale des Ingenieurs-Conseils* rregullat e (FIDIC). Klauzola e arbitrazhit është e bazuar në kapitullin e 67 të “Settlements and Disputes”.

Klauzola e kësaj kontrate është e vendosur në referencat e marrëveshjes nr. PEAP/CW/19-05, e cila ka rrjedhur si rezultat I një procesi të tenderit në vitin 2005.

I padituri, u pajtuar të paguaj çmimin e ndërtimit të punimeve në shumën totale prej 14,297,886.87 €, duke përfshirë edhe 15% VAT, 15% .....

Palët përdorën kushtet e përgjithshme të kontratës të përcaktuara në rregullat e FIDIC (të cilat mund të gjinden në “Red Book”). Ata I ndryshuan këto dispozita me disa kushte që ishin të

përcaktuara në nenet e kontratës. Në bazë të këtyre neneve ishte përcaktuar që nese do të lindte ndonjë kontest ndërmjet palëve, Tribunali I arbitrazhit do të përbëhej prej tre arbitrave, vendi I arbitrazhit do të jetë Prishtina dhe gjuha që do të përdoret është gjuha angleze. Poashtu, përcaktuan që ligji I cili do të zbatohet do të jetë ligji në fuqi në Angli dhe Wales.

Paditësi, ngriti padi në Tribunalin e Përhershëm të Arbitrazhit në Kosovë, duke kërkuar pagesat për çmimin e ndërtimit të punimeve në Airoportin e Prishtinës ku përfshiheshin renovimi I pistës dhe zgjerimi I airoportit siç ishin të përcaktuara në kontratë.

I padituri, në përgjigjen e tij në padi, nuk e kundërshtoi fuqinë e kontratës apo klauzolën që e përmbante ajo kontratë. I padituri, kundërshtoi juridiksionin e Tribunalit të arbitrazhit I cili udhëhiqej nga rregullat e Kosovës për arbitrazh tw vitit 2011, pasiqë, klauzola e arbitrazhit në kontratë përcakton që Tribunali I arbitrazhit duhet të vendoset në bazë të rregullave të International Chamber of Commerce (ICC).

I padituri, kërkoj të vendoset nga Tribunali nëse Tribunali ka apo nuk ka juridiksion të vendosë në këtë rast.

Me datën 5 mars 2013, palët u dakorduan dhe arritën një marrëveshje me të cilën përcaktohej që ligji I cili do të aplikohet në zgjidhjen e këtij kontesti do të jetë ligji I aplikueshëm në Kosovë. Në marrëveshje poashtu u specifikuar që I padituri ka të drejtën e kontestimit të juridksionit të Tribunalit të arbitrazhit.

Në padinë e paraqitur para Tribunalit, paditësi ka potencuar që i njejt rast është paraqitur edhe para Gjykatës Komunale të Prishtinës, me ç' rast, gjykata ka vendosur që zgjidhja e këtij kontesti nuk është në juridksionin e gjykatës.

Në ankesën e paraqitur nga ana e të paditurit, para Gjykatës Ekonomike në lidhje me vendimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës, Gjykata Ekonomike vendosi që nuk ka juridiksion të vendosë mbi çështjen. Përfundimisht, edhe Gjykata Supreme në Kosovë nxjerri vendimin e shkallës së tretë, me të cilën aprovoi vendimin e Gjykatës Ekonomike. Poashtu, Gjykata Supreme vendosi që Tribunali I arbitrazhit është **organi** që ka juridiksion për të zgjidhur këtë çështje. Kjo ngase palët janë pajtuar që kontesti do të zgjidhet me anë të arbitrazhit dhe jo me anë të gjykatave të rregullta, me ç' rast, ka përjashtuar juridiksionin e gjykatave të rregullta dhe vendimi është cilësuar si *res judicata*.

## **2. VLERËSIMI LIGJOR**

### **(a) Juridiksioni I Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit**

Tribunali I arbitrazhit ka konstatuar që në bazë të rregullave të Kosovës për arbitrazhin, Tribunali I arbitrazhit në kuadër të Odës Ekonomike nuk ka juridiksion të vendosë mbi këtë çështje. Kjo në bazë të faktit që kontrata përcakton që ky kontest duhet të zgjidhet në kuadër të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit që funksionon në bazë të rregullave të International

Chamber of Commerce (ICC) në Paris. Rregulla këto që ndryshojnë nga rregullat e arbitrazhit në Kosovë. Poashtu, I padituri në kohë ka kontestuar juridiksionin e Tribunalit të arbitrazhit në kuadër të Odës Ekonomike në Kosovë, gjë e cila ka rëndësi esenciale në këtë procedurë. Me ç'rast ka bërë të mundur zhvillimin e procedurës sa I përket kontestimit të juridiksionit të Tribunalit të arbitrazhit në Kosovë.

### **(b) Forma e kontratës**

Tribunali i arbitrazhit ka konstatuar se kontrata e nënshkruar në mes të palëve, përmban rregullat dhe klauzolën FIDIC, ku përcaktohet që kontestet që mund të lindin nga kjo kontratë duhet të rregullohen nga arbitrazhi i International Chamber of Commerce (ICC), në Paris.

Paditësi, në përgjigjen e tij kundrejtë kontestimit të juridiksionit të Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit në Kosovë, deklaroi që ky Tribunal ka juridiksionin dhe kompetencë ekskluzive për vendosjen dhe zgjidhjen e këtij kontesti. Paditësi, pajtohet që u përdorën kushtet e përgjithshme të kontratës të përcaktuara në rregullat e FIDIC (të cilat mund të gjinden në “Red Book”). Mirëpo, ata I ndryshuan këto dispozita me disa kushte që ishin të përcaktuara në nenet e kontratës. Në bazë të këtyre neneve ishte përcaktuar që nëse do të lindte ndonjë kontest ndërmjet palëve, Tribunali I arbitrazhit do të përbëhej prej tre arbitrave, vendi I arbitrazhit do të jetë Prishtina dhe gjuha që do të përdoret është gjuha angleze. Andaj, edhe Tribunali I arbitrazhit në Kosovë, ka juridiksionin dhe kompetencë ekskluzive për vendosjen dhe zgjidhjen e këtij kontesti.

I padituri, argumentoi që edhe pse palët janë pajtuar që vendi I arbitrazhit të jetë Prishtina, kjo nuk nënkupton që kompetent për zgjidhjen e këtij kontesti do të jetë Tribunali I Përhershëm I Arbitrazhit në Kosovë, dhe që duhet të aplikohen rregullat e Kosovës për arbitrazh të vitit 2011.

Pas interpretimit të rregullave dhe klauzolës së (FIDIC), Tribunali I arbitrazhit konstatoi që ky Tribunal nuk ka juridiksion për zgjidhjen e këtij kontesti, sepse, palët janë pajtuar që kompetent për zgjidhjen e kontesteve nga kjo kontratë do të jetë Tribunali I arbitrazhit të ICC-së. Kjo, duke u mbështetur në klauzolën e arbitrazhit në kontratë që përcakton që Tribunali I arbitrazhit duhet të vendoset në bazë të rregullave të ICC-së. Klauzolë kjo e bazuar në kapitullin e 67-të, të “Settlements and Disputes”, modeli i vitit 1992 të *Federatin Internationale des Ingenieurs-Conseils* rregullat e (FIDIC).

## **3. VENDIMI**

Tribunali i arbitrazhit ka vendosur që Tribunali I Përhershëm në Kosovë në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, nuk ka juridiksion për zgjidhjen e këtij kontesti. Poashtu është vendosur që vendimi mbi shpenzimet t'i lihet një Vendimi për Shpenzimet.

